# Republika e Kosovës

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

PRISHTINA

**Komuna e Prishtinës**

**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

---

**KRYETARI I KOMUNËS**

14-030/01 - 0098030/19, më 30-04-2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës nxjerr këtë

**U R D H Ë R E S Ë**

**I.** N D A L O H E T qarkullimi i të gjitha automjeteve, përveç autobusëve të NPL "Trafiku Urban", linja 4, automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të ndërmarrjes "Hortikultura", të KRM "Pastrimi", të Drejtorisë së Inspeksionit dhe automjeteve emergjente, për nder të Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Maji, më 1 maj 2019, në drejtim të parkut "Gërmia", ndërsa linja 5 e transportit publik do të punojë sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.

**II.** Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: "Normale", "Sofalia", "Tauk-Bahçe" dhe restoranteve - vilat: "Gërmia", "Freskia" dhe "Lira", do të jetë:

- Kryqëzimi i rrugëve "1 Tetori" – "Nazim Gafurri" dhe "Ymer Lutfi Paqarizi";
- Kryqëzimi i rrugëve "Nazim Gafurri" - "Xhavit Ahmeti" dhe "Dr. Lec Gradica";
- Kryqëzimi i rrugëve "Dr. Shpëtim Robaj" me atë të Sofalisë, në drejtim të pishinës dhe parkut "Gërmia".

**III.** Transporti publik i qytetarëve për në parkun "Gërmia" deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobusë të NPL "Trafiku Urban", linja 4.

**IV.** Inspektorët përgjegjës të Drejtorisë së Inspeksionit, për datën e cekur në pikën **I** të urdhëresës, do të:

- parandalojnë shërbyesit e paautorizuar që të bëjnë shitjen – shërbimin ndaj qytetarëve;
- organizojnë kujdestari, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme), si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.

**V.** Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.

VI. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e marrjes së saj.

U DORËZOHET:

- NPK "Trafiku Urban", linjat 4 dhe 5;
- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti